Energji Ashta Sh.p.k

Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(me Raportin e Audituesve të Pavarur)

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesve të Pavarur	
Bilanci kontabël	1
Pasqyrave e të ardhurave dhe shpenzimeve	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime për pasqyrat financiare	5-15

KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve të pavarur

Pronarit dhe drejtuesve të
Energji Ashta Sh.p.k

Tiranë, 30 prill 2014

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Energji Ashta Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga bilanci kontabël në 31 dhjetor 2013, pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Proçedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë proçedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Opinioni

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2013, rezultatin e saj financiar dhe flukset e saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Steven Nutley
Partner

KPMG Albania Sh.p.k.
"Deshmoret e Kombit" Blvd.
Twin Towers Building
Building I, 13th floor
Tirana, Albania

KPMG Albania Sh.p.k., an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International Cooperative ("KPMG International"), a Swiss entity.

Registered in the National Registration Center with VAT Number J91619001D

Energji Ashta Sh.p.k.
Bilanci kontabël

(Shumat në Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Aktivet			
Aktivet afatshkurtra			
Mjete monetare dhe depozita me bankat	4	1,238,122,214	2,406,557,335
Aktive te tjera	5	2,610,841,233	2,916,660,932
Llogari të arkëtueshme		990,824,459	35,603,330
Inventari		84,932,390	
Parapagime dhe shpenzime te shtyra		16,152,209	14,813,037
Totali i aktiveve afatshkurtra		**4,940,872,505**	**5,373,634,634**
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata të trupëzuara	6	23,473,484,579	21,774,610,057
Totali i aktiveve afatgjata		**23,473,484,579**	**21,774,610,057**
Totali i aktiveve		**28,414,357,084**	**27,148,244,691**
Kapitali			
Kapitali aksionar	7	10,782,456,500	10,782,456,500
Humbje të mbartura		(6,956,404,407)	(7,839,126,828)
Totali i kapitalit		**3,826,052,093**	**2,943,329,672**
Detyrimet			
Detyrimet afatshkurtra			
Detyrime ndaj palëve të lidhura	8	5,041,232,037	3,802,274,252
Të pagueshme ndaj furnitorëve	9	16,242,945	1,270,446,557
Pjesa afat-shkurtër e huave afatgjata	11	1,121,525,792	238,877,670
Detyrime të tjera	10	8,054,217	21,980,610
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**6,187,054,991**	**5,333,579,089**
Detyrimet afatgjata			
Hua afatgjata	11	18,401,250,000	18,871,335,930
Totali i detyrimeve afatgjata		**18,401,250,000**	**18,871,335,930**
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		**28,414,357,084**	**27,148,244,691**

Bilanci duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri 15.

Energji Ashta Sh.p.k.
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

(Shumat në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Të ardhura	12	1,764,505,163	-
Kosto personeli	13	(75,125,848)	(60,322,684)
Rimarrje/ (humbje) nga zhvleresimi	6	1,193,727,402	(7,113,020,291)
Amortizimi	6	(872,887,210)	(4,302,644)
Shpenzime të tjera operative	14	(322,620,522)	(230,234,816)
Rezultati nga veprimtaria operative		**1,687,598,985**	**(7,407,880,435)**
Interesi dhe të ardhura të tjera		40,827,340	658,177
Interesi dhe shpenzime të tjera financiare		(757,665,370)	-
Humbja neto nga kurset e kembimit		(88,038,534)	(94,018,480)
Humbja neto financiare		**(804,876,564)**	**(93,360,303)**
Fitimi/(humbja) e vitit para tatimit		**882,722,421**	**(7,501,240,738)**
Tatimi mbi fitimin	15	-	-
Fitimi/(humbja) neto e vitit		**882,722,421**	**(7,501,240,738)**

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri 15.

Energji Ashta Sh.p.k.
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital

(Shumat ne Lek)

	Kapitali aksionar	Humbje te akumuluara	Totali
Teprica me 1 janar 2012	**10,782,456,500**	**(337,886,090)**	**10,444,570,410**
Humbja neto e vitit	-	(7,501,240,738)	(7,501,240,738)
Teprica me 31 dhjetor 2012	**10,782,456,500**	**(7,839,126,828)**	**2,943,329,672**
Fitimi neto i vitit	-	882,722,421	**882,722,421**
Teprica me 31 dhjetor 2013	**10,782,456,500**	**(6,956,404,407)**	**3,826,052,093**

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare te paraqitura ne faqet 5 deri 15.

Keto pasqyra financiare jane aprovuar nga Drejtimi i Energji Ashta Sh.p.k. me 30 prill 2014 dhe nenshkruar nga:

Stelzer Peter
Administrator

Dietmar Reiner
Administrator

Fatbardha Bytyci
Menaxhere e Financës

Energji Ashta Sh.p.k.
Pasqyra e flukseve monetare

(Shumat në Lek)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Fluksi nga veprimtaritë operative		
Fitimi/(humbja) neto e periudhes	882,722,421	(7,501,240,738)
Rregullime për:		
(Rimarrje)/humbje nga zhvleresimi	(1,193,727,402)	7,113,020,291
Amortizimi	872,887,210	4,302,644
	561,882,229	**(383,917,803)**
Ndryshime në parapagime, të arkëtueshme, aktive të tjera	(650,740,602)	(782,074,578)
Ndryshime në depozita e mjete monetare të kufizuara	1,111,305,392	4,841,351
Ndryshime në inventar	(84,932,390)	-
Ndryshime në të pagueshme ndaj palëve të lidhura	1,238,957,785	(721,845,137)
Ndryshime në te pagueshme ndaj furnitorëve	(1,254,203,612)	(1,155,419,719)
Ndryshime në detyrime të tjera	(13,926,393)	2,578,028
Mjete monetare nga /(përdorur) në veprimtari operative	**908,342,409**	**(3,035,837,858)**
Tatim fitimi i paguar	-	-
Mjete monetare nga /(përdorur) në veprimtari operative	**908,342,409**	**(3,035,837,858)**
Fluks nga veprimtari investuese		
Shtesa neto në aktivet në proces	(1,336,804,202)	(6,473,298,505)
Blerje e aktiveve të tjera të trupëzuara	(41,230,128)	(20,008,068)
Mjetet monetare përdorur në veprimtari investuese	**(1,378,034,330)**	**(6,493,306,573)**
Fluks nga veprimtari financuese		
Rritje fondesh nga huatë	412,562,192	4,600,575,466
Mjetet monetare neto nga veprimtari financuese	**412,562,192**	**4,600,575,466**
Ulja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente	**(57,129,729)**	**(4,928,568,965)**
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	138,781,746	5,067,350,711
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor (shënimi 4)	**81,652,017**	**138,781,746**

Pasqyra flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri 15.

(Shumat në Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Energji Ashta Sh.p.k. ("Shoqëria") është regjistruar ne 11 dhjetor 2008. Zyra qendrore e shoqërisë është e vendosur në Tiranë, Shqipëri.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1363, datë 22 tetor 2008 " Për miratimin e Marreveshjes së Koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Österreichische Elektrizitätswirtschafts-Aktiengesellschaft, për ndërtimin, pronësine, përdorimin dhe transferimin e projektit për Hidrocentralin e ri në Ashtë, në Republikën e Shqipërisë", Qeveria Shqiptare, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ("METE") dhe Shoqëria hynë në një Marrëveshje Koncesioni, datë 17 tetor 2008 ("Marrëveshja e Koncesionit").

Objektivi kryesor i Shoqerisë është zbatimi i Marreveshjes së Koncesionit. Koncesioni jepet për një periudhë 35 vjecare, duke filluar nga 17 tetori 2008. Bazuar në Marrëveshjen e Koncesionit Shoqërise i caktohen si më poshtë:

(i) projektimi, financimi, ndërtimi, testimi, zotërimi, veprimtaria dhe mirëmbajtja e hidrocentralit;

(ii) pasurimi dhe rinovimi i objekteve ekzistuese, të zotërojë pjesët e pasuruara dhe të rinovuara të objekteve ekzistuese sipas kërkesave ligjore dhe te përdore dhe mirëmbajë objektet ekzistuese;

(iii) të gezojë uzufruktet;

(iv) të ketë të drejtë përdorimi të ujit në nivelin më të ulët të lumit Drin (brenda zonës së koncesionit);

(v) të furnizojë KESH me prodhim të përkohshëm dhe me prodhim neto të energjisë elektrike dhe të mbledhë pagesat e bleresve në përputhje me kohen dhe kushtet e Marreveshjes për Shitjen e Energjisë, dhe t'i shesë palëve të treta prodhimin neto të energjisë elektrike në një treg të hapur;

(vi) t'i rikthejë Qeverisë Shqiptare përdorimin e zonës së koncesionit dhe të drejtën për transferim, dhe t'i transferojë Qeverisë Shqiptare pronësine e hidrocentralit dhe objekteve ekzistuese me perfundimin e periudhës së koncesionit;

(vii) të ketë të drejten ekskluzive mbi cdo atribut mjedisor të lindur nga projekti, duke përfshirë edhe certifikimet që lidhen me të.

2. BAZA E PËRGATITJES

(a) Deklarata e perputhshmerise

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi baza të kostos historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është dhe monedha funksionale dhe e prezantimit për Shoqerinë.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlerësimet dhe supozimet e përmendura rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhen në të cilën vleresimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

(Shumat në Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Aktivet afatgjata të trupëzuara

(i) Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata te trupëzuara maten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih me poshtë) dhe humbjet nga rënia në vlerë, nësa ka.

Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërsëdrejti me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë, përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nëse përfshihet), cdo kosto tjetër që lidhet drejtpërsëdrejti me përgatitjen e aktiveve për gjëndje pune, për qëllimin e përdorimit të tyre; shpenzimet e cmontimit dhe heqjes se elementëve dhe rikthimin e terrenit ku ato ndodhen në gjëndjen fillestare, dhe kostot e huamarrjes që lidhen me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve përkatëse.

Kur pjesë të një objekti të aktiveve afatgjata te trupëzuara kanë jetëgjatesi të ndryshme, ato kontabilizohen si pjesë të vecanta (përbërës kryesore) të aktiveve afatgjata të trupëzuara.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e nje objekti te aktiveve afatgjata te trupezuara percaktohen duke krahasuar te ardhurat nga shitja me vleren e mbartur, dhe jane te njohura si te ardhura neto ne kategorine e te ardhurave te tjera, ne fitim ose humbje.

(ii) Kostot vijuese

Kostot e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata te trupëzuara i shtohet vlerës së mbetur të elementit nëse është e mundur që përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me këtë element do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund te matet me saktësi. Kostot e mirëmbajtjeve të vazhdueshme të aktiveve afatgjata njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve të trupëzuara përllogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur me norma si me poshte:

• Ndërtesa	5%
• Makineri	5%
• Instalime elektrike	5%
• Aktive të tjera të trupëzuara	20%-25%

Jeta e dobishme, metodat e amortizimit dhe vlera e mbetur, nëse nuk janë jodomethënëse, rivlerësohen në datën e raportimit. Toka dhe aktivet në proces nuk zhvlerësohen.

(b) Inventari

Inventari vlerësohet me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.Vlera neto e realizueshme është cmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të aktivitetit të biznesit minus kostot e vlerësuara të shitjes dhe përfundimit.

Kosto e inventarit përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e shndërimit dhe kosto të tjera të ndodhura me qëllim sjelljen e inventarit në gjendjen dhe vendndodhjen aktuale.

(c) Instrumentat financiare

Shoqëria mban vetëm instrumenta financiare jo derivative, përfshire llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalentë të saj, hua, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera.

Gjithë aktivet dhe detyrimet financiare njihen fillimisht në datën e blerjes në të cilën Shoqëria bëhet palë e parashikimeve kontraktuale të instrumentit. Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejte shtuar kostot e transaksionit që i atribohen drejtpërdrejtë blerjes ose emetimit të tij.

Shoqëria çregjistron nje aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin prej aktivit përfundojne, ose ajo i transferon të drejtat për të marrë flukse monetare kontraktuale nga aktivi financiar nëpërmjet një transaksioni, ku në mënyre thelbësore gjithë risqet dhe përfitimet e pronësise së aktivit financiar transferohen.

(Shumat në Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

(c) Instrumentat financiare (vazhdim)

Çdo interes mbi aktivet financiare të transferuara që krijohen ose mbahen nga Shoqëria, njihet si një aktiv ose detyrim i vecantë.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e tij kontraktuale shlyhen, ose anullohen, ose përfundojnë.

Pas njohjes fillestare, instrumentat financiare jo-derivative maten sic përshkruhet më poshtë:

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjete monetare dhe ekuvalente me to përfshijne paranë në arkë, llogari rrjedhëse në bankë, investime te tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, dhe përdoren nga Shoqëria ne manaxhimin e angazhimeve te saj afatshkrutra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbarten me koston e amortizuar në bilancin kontabël.

Huatë

Huatë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arketueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera

Pas njohjes fillestare llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera njihen me koston e amortizuar.

d) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërise njihet me vlerën nominale.

(e) Provigjionet për risqe

Nje provigjion njihet kur Shoqëria, si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose strukturor, që mund të matet në mënyre të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohet një dalje e flukseve të të mirave ekonomike për të shlyer detyrimin. Provigjionet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare me një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimit.

(f) Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëhere kur rreziqet dhe përfitimet thelbësore të pronësisë janë transferuar tek blerësi, marrja e kompensimit është e mundur, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme të mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të mëtejshme të manaxhimit në energjinë e shitur, si dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme. Të ardhurat maten neto nga kthimet, zbritjet tregtare si dhe kompensimet e vëllimit. Për shitjen e energjisë elektrike, transferimi zakonisht ndodh kur sasia aktuale e energjisë është injektuar në rrjetin e transmetimit dhe është matur në pikën e furnizimit.

Bazuar në marrveshjen 'Off-Take' me KESH Sh.a. më datë 30 shtator 2008, Shoqëria deklaron sasinë e disponueshme ditore të elektricitetit ('Prodhimi i Deklaruar'), dhe kur sasia aktuale ('Prodhimi Neto') është e ndryshme nga Prodhimi i Deklaruar, bëhen rregullimet e nevojshme për të kompensuar të tilla devijime. Shuma e kompensimit matet si diferenca midis Prodhimit të Deklaruar dhe Prodhimit Neto gjatë ditës, shumëzuar me një cmim të rregulluar. Shoqëria paguan kostot e kompensimit, kur Prodhimi Neto është më i ulët se Prodhimi i Deklaruar dhe përfiton të ardhura nga kompensimi, atëhere kur Prodhimi Neto e tejkalon Prodhimin e Deklaruar. Kompensimi i përfituar paraqitet si e ardhur ndërsa kostoja e kompensimit paraqitet në shpenzime të tjera operative. Bazuar në të njëjtën marreveshje, KESH duhet t'i sigurojë Shoqërisë furnizimin e sasisë së nevojshme të ujit për funksionimin e hidrocentralit. Në rast se devijimet nga Prodhimi i Deklaruar janë pasojë e sasisë së pamjaftueshme të ujit të furnizuar nga KESH, Shoqëria përfiton një kompensim për mungesën e sasisë së nevojshme të ujit nga KESH, i cili përfshihet në të ardhura.

(Shumat në Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Qiraja operative

Pagesat e kryera sipas qirasë operative njihen në paqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve mbi baza lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë. Pagesat nxitsëse të qirasë të marra njihen si pjesë integrale e shpenzimit total të qirase, përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

(h) Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidence objektive që tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivit financiar.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar te matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv.

Aktivet financiare individuale materiale, janë testuar për zhvlerësim mbi baza individuale. Aktivet e mbetura financiare jane vleresuar se bashku ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut te kreditimit. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret ne rast se rimarrja mund të lidhet në mënyre objektive me ngjarje që ndodhin pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlerat në pasqyrat financiare te Shoqërise për aktivet jo-financiare, përvec inventarëve, rishikohen në çdo datë raportimi, nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin. Në rast se ekziston një tregues i tillë, atëhere vleresohet vlera e rekuperueshme e aktivit. Nje humbje nga zhvleresimi njihet kur vlera e mbartur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Nje humbje nga zhvlerësimi njihet kur vlera e mbartur e një aktivi ose e njësise përkatese të gjenerimit të parase, tejkalon vlerën e tij të rekuperueshme. Një njësi gjenerimi e parasë është grupi më i vogël, i identifikueshëm i aktiveve, i cili gjeneron flukse parash të cilat jane të pavarura nga aktive dhe grupe te tjera. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlera e rekuperueshme e aktivit ose njësise së gjenerimit të parase është më e madhja mes vleres në përdorim dhe vlerës së drejtë, minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të parasë skontohen, duke përdorur përqindjen e skontimit para taksës, që reflekton vlerësimet aktuale të tregut, të vlerës në kohë të parasë, dhe risqet specifike të aktivit.

Në lidhje me aktivet e tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret kur ka tregues se zhvlerësimi nuk ekziston më dhe ka ndodhur një ndryshim në vlerësimet e perdorura per te caktuar vleren e rekuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret në masën që vlera e mbetur e aktivit, nuk tejkalon vlerën kontabël, neto nga amortizimi, në rast se nuk do ishte njohur humbje nga zhvleresimi.

(i) Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit, kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj në vend, si kontributit të detyrueshëm të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, sipas legjislacionit vendas. Kostot ne e Shoqërise njihen ne pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën kur ndodhin.

(j) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën ndodhin.

(k) Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat financiare përfshijne të ardhurat nga interesat nga fondet e investuara. Të ardhurat nga interesat njihen ndërsa përllogariten në pasqyrën e të ardhurave, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga veprimet në monedhë të huaj raportohen në baza neto.

(Shumat në Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

(l) Tatimi mbi të ardhurat

Tatimet mbi të ardhurat njihen në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar të tatimit mbi të ardhurat. Shoqëria nuk njeh tatim të shtyre dhe shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat përbehet vetëm nga tatimi i periudhes aktuale.

(m) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë përkthyer në monëdhen funksionale raportuese, me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit janë përkthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Humbja ose fitimi nga zerat monetare, është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj, e përkthyer me kursin e këmbimit në fund të periudhes. Aktivet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj të cilat janë matur me vlerën e drejtë, përkthehen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë, kurse ato që maten me kosto historike janë konvertuar me kursin e këmbimit ne datën e transaksionit.

4. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Llogari rrjedhëse		
Në Lek	17,161,166	78,803,085
Në Euro	64,490,851	59,978,661
Depozita me afat	1,156,470,197	2,267,775,589
Totali	**1,238,122,214**	**2,406,557,335**
Depozita me afat mbi tre muaj	(10,219,921)	(34,335,589)
Mjete monetare të kufizuara	(1,146,250,276)	(2,233,440,000)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	**81,652,017**	**138,781,746**

Mjetet monetare të kufizuara paraqesin shuma të bllokuara nga Raiffeisen Bank për periudha kontraktuale prej më shumë se tre muaj. Shumat janë të bllokuara për të siguruar garancitë bankare të marra. Këto shuma janë ne Euro.

5. AKTIVE TË TJERA

Aktive të tjera përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
TVSH e arketueshme	2,575,565,561	2,879,843,423
Parapagime per tatim fitimin e kompanisë	8,360,102	8,360,102
Parapagime te tjera tatimore	6,387,890	6,434,975
Prepayments to suppliers	20,527,680	22,022,432
Totali	**2,610,841,233**	**2,916,660,932**

Deri më 31 dhjetor 2013, autoritetet tatimore kanë kryer rimbursime kumulative prej 410,000,000 Lek në lidhje me TVSH-në. Gjatë tremujorit të parë të 2014, autoritetet tatimore njohën një TVSH të kredituesshme në shumën e 1,031,851,555 Lek e cila u netua me detyrimet ndaj doganave në 2014, dhe në prill 2014 u rimbursua nga autoritetet tatimore një shtesë prej 434,731,114 Lek.

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

6. AKTIVE AFATGJATA TË TRUPËZUARA

	Toka dhe ndërtesa	Makineri	Instalime elektrike	Aktive të tjera të trupëzuara	Aktive në proçes	Totali
Kosto						
Më 1 janar 2012	-	-	-	14,363,188	22,386,867,341	22,401,230,529
Kosto ndërtimi	-	-	-	-	5,307,939,672	5,307,939,672
Kosto huamarrjeje	-	-	-	-	1,165,358,833	1,165,358,833
Shtesa të tjera	-	-	-	20,008,068	-	20,008,068
Më 31 dhjetor 2012	**-**	**-**	**-**	**34,371,256**	**28,860,165,846**	**28,894,537,102**
Kosto ndërtimi				-	1,228,212,426	1,228,212,426
Kosto huamarrjeje				-	164,465,518	164,465,518
Shtesa të tjera				41,230,128	-	41,230,128
Transferime	13,853,190,956	12,754,535,719	3,569,543,377	19,699,996	(30,196,970,048)	-
Pakësime në aktive	-	-	-	-	(55,873,742)	(55,873,742)
Më 31 dhjetor 2012	**13,853,190,956**	**12,754,535,719**	**3,569,543,377**	**95,301,380**	**-**	**30,272,571,432**
Amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar						
Më 1 janar 2012	-	-	-	(2,604,110)	-	(2,604,110)
Humbje nga zhvlerësimi	-	-	-	-	(7,113,020,291)	(7,113,020,291)
Shpenzim amortizimi i vitit	-	-	-	(4,302,644)	-	(4,302,644)
Më 31 dhjetor 2013	**-**	**-**	**-**	**(6,906,754)**	**(7,113,020,291)**	**(7,119,927,045)**
Transferime	(3,252,137,218)	(3,016,633,942)	(844,249,131)	-	7,113,020,291	-
Rimarrje e humbjes nga zhvlerësimi	545,782,966	506,260,133	141,684,303	-	-	1,193,727,402
Shpenzim amortizimi i vitit	(393,679,596)	(365,171,317)	(102,198,534)	(11,837,763)	-	(872,887,210)
Më 31 dhjetor 2013	**(3,100,033,848)**	**(2,875,545,126)**	**(804,763,362)**	**(18,744,517)**	**-**	**(6,799,086,853)**
Vlera e mbartur						
Më 1 janar 2012	-	-	-	**11,759,078**	**22,386,867,341**	**22,398,626,419**
Më 31 dhjetor 2012	**-**	**-**	**-**	**27,464,502**	**21,747,145,555**	**21,774,610,057**
Më 31 dhjetor 2013	**10,753,157,108**	**9,878,990,593**	**2,764,780,015**	**76,556,863**	**-**	**23,473,484,579**

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

6. AKTIVE AFATGJATA TË TRUPËZUARA (VAZHDIM)

Kostot e ndërtimit përfshijnë blerjen e tokës, tarifat për licensat punë civile dhe inxhinierike, pajisje elektrike dhe hidro-mekanike, konsulence, projektimi dhe aplikim projekti, vleresimin e ndikimit mjedisor, monitorimin ekologjik dhe hetimin ne teren.

Energji Ashta Shpk ishte në ndërtim të hidrocentralit matricë me dy-faza, me një prodhim të instaluar prej 53 MW në lumin Drin në veri të Shqipërisë konceptuar në kuadrin e një modeli të operatorit. Dy hidrocentralet filluan aktivitetin gjatë muajit prill 2013.

Zvogëlimi i pritshmërisë për Energji Ashta Shpk në lidhje me të ardhurat nga shitja e certifikatave per pakesim ndotjesh (CER) ishin tregues i zhvlerësimit, sic ishin dhe shpenzimet per investime dhe rreziku i vendit me ndikim në normën e skontimit. Gjatë vitit 2012, shuma e rikuperueshme është rivlerësuar dhe përcaktohet në bazë të vlerës në përdorim. Në 2013, duke ndjekur disa ndryshime në kushtet e tregut Shoqërisa rivlerësoi përcaktimet e saj dhe rimori pjesë të zhvlerësimit të njohur fillimisht. Vlera e përdorimit ishte përcaktuar duke përdorur një metodë të vlerës neto aktuale. Shuma është llogaritur bazuar në metodën e skontimit (DCF). Norma e skontimit para tatimit për periudhën e planifikimit shkonte nga 8.5% në 10.0% në vit (2012: 8.75% deri në 10.25 në vit).

Flukset e parave te perdorura ishin nga planet e brendshme te Energji Ashta Shpk. Përcaktimi i vlerës së drejtë është bazuar në daljet e vazhdueshme gjatë periudhës së planifikimit që korrespondon me aftësit mesatare të energjisë. Çmimet për 15 vitet e para pas komisionimit u përcaktuan në bazë të marrëveshjes së blerjes të energjisë elektrike me KESH-in (shënim 1); çmimet e energjisë elektrike për vitet e mëvonshme u vendosën në bazë të një modeli të tregut të energjisë të zhvilluar. Periudha e planifikimit përfshinte afatin e pritshëm të koncesionit të hidrocentraleve.

Supozimet bazë që janë kyçe për vlerësimin dhe percaktimin e shumës së rikuperueshme, përfshijnë cmimet e parashikuara të energjisë për periudhën që pason fundin e marrëveshjes për blerjen e energjisë, të ardhurat nga shitja e çertifikatave të reduktimit të ndotjeve, periudha e pritshme për koncesionin e hidrocentralit dhe norma e skontimit.

Shuma e rikuperueshme u krahasua me vlerën kontabël të totalit të aktiveve. Bazuar në vleresimin e bërë në vitin 2013, vlera kontabël u vlerësua në 1,193,727,402 Lek më pak (2012: 7,113,020,291 më shumë) se vlera e rikuperueshme dhe për këtë shumë u rimorr një humbje nga zhvleresimi (2012: u shtua humbja). Meqënëse rikuperimi i aktiveve financiare është supozuar i plotë, zhvlerësimi u shpërnda tërësisht tek aktivet në proces.

7. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali i paguar është i regjistruar në Lek. Energji Ashta Sh.p.k. fillimisht ishte në pronësi të Verbund-International GmbH. Disa transferime pasuese të kapitalit aksionar u bazuan ne marreveshjet e blerjes së aksioneve si më poshtë:

- 20 prill 2010: 50% e kapitalit aksionar u transferua nga Verbund-International GmbH tek EVN A.G;
- 13 janar 2011: 50% e kapitalit aksionar u transferua nga Verbund-International GmbH tek Hydro Power Verbund AG;
- 6 shtator 2011: Hydro Power Verbund AG dhe EVN AG transferuan 100% të aksioneve tek Ashta Beteiligungsverëaltung GmbH.

Struktura e pronesise është si më poshtë:

	31 dhjetor 2013		31 dhjetor 2012	
	Total në Lek	**%**	**Total në Lek**	**%**
Ashta Beteiligungsverwaltung GmbH	10,782,456,500	100	10,782,456,500	100

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

8. DETYRIMET NDAJ PALEVE TE LIDHURA

Detyrimet ndaj palëve të lidhura paraqet tepricën e një llogarie me VERBUND Finanzierungsservice GmbH. Kjo llogari perdoret për të mbledhur ose shlyer pagesat me palët e treta ose palët e lidhura, dhe për të marrë fonde nga pronaret. Keto teprica janë në Euro dhe mbartin një interes 1-mujor Euribor + 1.3%.

9. TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Punë ndërtimi të pafaturuara	-	697,965,589
Detyrime të mbajtura	-	410,691,592
Detyrime të tjera ndaj furnitoreve	16,242,945	161,789,376
Totali	**16,242,945**	**1,270,446,557**

Punët e ndërtimit të pafatururara paraqesin punën e kryer përpara fundit të vitit, por të pafaturuara ende. Shumat e njohura në 31 dhjetor 2012 janë bazuar mbi marrëveshjet. Detyrimert e mbajtura paraqesin një perqindje të shumës së faturuar nga furnitorët, e cila bazuar në marrëveshje kontraktuale, është e pagueshme pasi puna të përfundohet.

10. DETYRIME TE TJERA

Detyrime të tjera përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Shpenzime të përllogaritura	6,691,560	20,785,946
Tatimit mbi të ardhurat e personelit	635,402	519,399
Sigurime shoqërore	727,255	668,275
Detyrime dhe taksa të tjera	-	6,990
Totali	**8,054,217**	**21,980,610**

11. HUATE AFATGJATA

Huatë janë marrë nga palët e mëposhtme:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Verbund International Finance GmbH	9,761,387,896	9,555,106,800
Bawag P.S.K Bank	-	9,555,106,800
Raiffeisen Bank International	9,761,387,896	-
Totali	**19,522,775,792**	**19,110,213,600**
Detyrimi afatshkurter	**1,121,525,792**	**238,877,670**
Detyrimi afatgjate	**18,401,250,000**	**18,871,335,930**

Në 15 tetor 2010 Shoqëria mori dy hua me një total limiti kreditimi prej 140 milionë Euro dhe kohezgjatje prej 10 vjet. Keto hua mbartin nje interes prej Euribor 3-mujor + 1.35%.

Në 15 korrik 2013 Shoqëria shleu borxhin me Bawag P.S.K Bank në shumën prej 70 milionë Euro dhe morri një hua të re nga Raiffeisen Bank International për të njëjtën shumë.Huamarrja e re mban normë interesi të ndryshueshme, aktualisht prej 3.38%. Huamarrja është e pagueshme në tridhjetë e pesë këste tremujore duke filluar nga 15 tetori 2013. Një tjetër marrëveshje e huamarrjes me të njëjtat terma dhe kushte u nënshkrua me Verbund International Finance GmbG.

Huatë janë garantuar nga aksionerët, dhe për këto garanci Shoqëria u paguan atyre, një tarife prej 2% mbi shumën e mbetur të huave.

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

12. TË ARDHURAT

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2012
Shitja e energjisë	1,749,076,965	-
Kompensimet për ujë	11,823,514	
Kompensimet për energji	3,604,684	-
Totali	**1,764,505,163**	**-**

Shoqëria finalizoi fazën e ndërtimit të hidrocentraleve në prill 2013 dhe nisi t'i shesë energji elektrike KESH Sh.a. (shiko shënimin 3.(e)).

13. KOSTOT E PERSONELIT

Kostot e personelit përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2012
Paga	69,104,242	55,255,373
Sigurime shoqërore	6,021,606	5,067,311
Totali	**75,125,848**	**60,322,684**

Në 31 dhjetor 2013, Shoqëria kishte punësuar 29 punonjës (2012: 27).

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

14. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

Shpenzimet e tjera operative përbehen si më poshtë:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2012
Sherbime profesionale konsulence	94,221,801	86,034,519
Humbje nga pakesimet e aktiveve	55,873,742	-
Kostot e kompensimit (shënimi 3.(e))	34,695,963	-
Tarifa koncesioni	18,418,026	-
Shpenzime per sigurime	19,963,542	17,060,457
Mirembajtje dhe riparime	28,434,681	17,362,891
Shpenzime qiraje	14,404,218	21,476,042
Shpenzime perfaqesimi	16,639,521	34,697,743
Shpenzime postare dhe telefoni	9,593,292	12,981,948
Shpenzime per publicitet e marketing	8,145,988	13,702,738
Gjoba për TVSH dhe taksa të tjera	8,096,536	49,865
Materiale zyre	5,141,670	3,435,743
Shpenzime transporti	3,420,875	3,810,048
Taksa dhe tarifa te tjera	1,608,379	966,572
Kompensime bankare	353,063	407,870
Shpenzime kompensimi	-	15,348,200
Të tjera	3,609,225	2,900,180
Totali	**322,620,522**	**230,234,816**

Rritja e përgjithshme në shpenzimet e tjera operative lidhet me përfundimin e fazave të ndërtimit dhe testimit të hidrocentralit dhe nisjen e fazës së prodhimit gjatë tremujorit të dytë të vitit 2013.

Bazuar në marrëveshjen e koncesionit Shoqëria paguan tarifa koncesioni prej 2% të prodhimit neto të energjisë.

Shpenzimet e kompensimit prej 15,348,200 Lek të paguara në vitin 2012, perfaqësojne pagesa të rëna dakord me fermerët, për dëme që u janë shkaktuar atyre gjatë ndërtimit të hidrocentralit.

15. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria përcakton tatimin ne fund të vitit në përputhje me Legjislacionin tatimor shqiptar. Në vitet 2013 dhe 2012, norma e tatim fitimit në Shqipëri ishte 10% mbi rezultatin tatimor. Më poshtë paraqitet rakordimi i tatim fitimit të përllogaritur me normat e aplikuesheme tatimore me shpenzimin:

	Norma tatimore efektive	2013	Norma tatimore efektive	2012
Humbja përpara tatimit		**882,722,421**		**(7,501,240,738)**
Tatimi prej 10%	10.0%	88,272,242	10%	(750,124,074)
Rimarrje të patatueshme të humbjes nga zhvlerësimi	(13.5%)	(119,372,740)	-	-
Humbje të pazbritshme zhvlerësimi	-	-	(9.5%)	711,302,029
Shpenzime të pazbritshme	0.6%	5,643,478	(0.1%)	6,148,656
Humbje të mbartura	2.9%	25,457,020	(0.4%)	32,673,389
Shpenzimi i tatim fitimit	-	-	-	-

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

16. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Shoqëria ka marrë financim nga palët e lidhura dhe garanci prej tyre për huate që ka marrë (shih shënimet 8 dhe 11).

Shpenzimet e paguara per palet e lidhura ishin si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Verbund Hydro Power AG: shpenzime operative	42,835,100	32,621,624
Verbund Finanzierungsservice: shpenzime financiare	1,231,565	2,144,938
	44,066,665	**34,766,562**

17. ANGAZHIME DHE KUSHTEZIME

Ligjore

Ne rrjedhen normale të biznesit, Shoqëria ndeshet me pretendimet ligjore dhe gjyqësore; menaxhimi i Shoqërisë është i mendimit se asnjë humbje materiale nuk do të shkaktohet në lidhje me kërkesat ligjore të pazgjidhura më 31 dhjetor 2013.

Angazhimet e qerasë operative

Shoqëria ka hyrë në angazhime të qerasë për zyrat e saj. Shoqëria mund të anulloje këto qera duke lajmëruar 3 muaj përpara. Prandaj, më 31 dhjetor 2013, maksimumi i angazhimeve të paanullueshme, të pagueshme jo më vonë se 1 vit është 1,619,310 Lek (2012: 1,576,250 Lek).

18. NGJARJET PAS DATES SE RAPORTIMIT

Nuk ka pasur ndonjë ngjarje pasuese domethënëse pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullim ose shpjegim në këto pasqyra financiare.